




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR' S OFFICE – BAŞKAN OFISI

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2016

Komuna e Gjilanit



PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS	4
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRASTRUKTURË DHE BANIM	7
PLANIFIKIMI PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRASTRUKTURË DHE BANIM.....	7
DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT	13
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	17
PROJEKTET ME PRIORITET TË DUPMM PËR PERIUDHE JANAR-DHJETOR 2016 ..	23
DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI.....	24
SEKTORI I BLEGTORISË	24
SEKTORI I LAVËTARISË DHE PERIMKULTURËS.....	26
SEKTORI I PEMËTARISË.....	27
AKTIVITETET TJERA TË PËRGJITHSHME QË PLANIFIKOHËN NË DREJTORIN E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË JANË:	29
DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK	31
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM	40
PLANI I PUNËS I ZYRËS SË PREVENTIVËS PËR VITIN 2016	42
PLANI I PUNËS PËR NJËSINË PROFESIONALE TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT PËR VITIN 2016.....	43
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME	46
SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE	46
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE (QSHQ)	49
DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË.....	50
FUSHËVEPRIMTARIA E DREJTORISË.....	50
ORGANIZIMI I BRENDSHËM.....	51
PLANIFIKIMI	52
DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE E MIRËQENIES SOCIALE.....	65
PROJEKTET E DREJTORISË.....	66
QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE ”DR.NAGIP REXHEPI”	67
QENDRA PËR PUNË SOCIALE	72
NJËSIA PËR KULTURË, RINI E SPORT	73
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	88

DEPARTAMENTI I PROKURIMIT	91
PLANI I PUNËS PËR VITIN 2016 I KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT	99
ANEKS 1: PROJEKTET SIPAS PRIORITETEVE NË KOMUNËN E GJILANIT	104
PROJEKTET SIPAS PRIORITETEVE NË QYTET	104
PROJEKTET SIPAS PRIORITETEVE NË FSHATRA	105
NDËRTIMI I TROTUAREVE	107
NDËRTIMI I KANALIZIMEVE	108
NDËRTIMI I HAPËSIRAVE TË GJELBËRTA	109
LISTA E PROJEKTEVE TË TJERA ME RËNDËSI 2016	110
LISTA E PROJEKTEVE TË PARAPARA NGA DONATORËT 2016.....	113

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS

Të nderuar qytetarë të Komunës së Gjilanit,

Viti 2016 do të jetë vit i investimeve për Komunën e Gjilanit, vit i cili do të na i konkretizojë planet dhe punët përgatitore të cilat i kemi bërë në vitin paraprak. Pa dashur të kthehem në vitet e kaluara, më duhet të përmendi që Komunën e Gjilanit e kemi gjetur të zhytur në borxhe, dhe ka qenë shumë e vështirë t'i përgjigjemi të gjitha kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të Gjilanit, edhe pse deri në fund ia kemi dalë mjaft mirë. Ndërsa, tani falë angazhimit të madh dhe ekipit tim në kuadër të Komunës, falë bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe falë miqve ndërkombëtarë që ende janë prezent në Kosovë si donatorë, ne do të realizojmë objektivat tona dhe premtimet të cilat i kemi dhënë duke investuar në infrastrukturë, në ujë të pijshëm, kanalizim dhe duke shkuar drejt një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm.

Për çdo planifikim duhet të kemi edhe burimet e financimit. Prandaj, këtë vit ne presim rezultate edhe më të mira, sidomos nga të hyrat e tatimit në pronë. Komuna e Gjilanit është Komunë e cila vazhdon të jetë e përgjegjshme karshi pagesave të tatimit në pronë. Për këtë, u jemi thellësisht mirënjohës banorëve tonë.

Ndihemi të lumtur që kemi disa kategori të investimeve në Gjilan, dhe ndër më të rëndësishmet është ajo e dhuruesëve (donatorëve). Gjilani ka arritur që të bashkëpunojë dhe të marrë donacione nga çdo qeveri që është prezent në Kosovë apo është në buxhetim me financa në Kosovë.

Investitori më i madh në Gjilan aktualisht është Qeveria e Zvicrës, e cila pritet ta rehabilitoj rrjetin e ujësjellësit për të gjitha fshatrat dhe implementues është ndërmarrja "Hidromorava." Programi është bërë nga Komuna në bashkëpunim me Qeverinë zvicerane. Partneri i dytë i madh është Komisioni European me të cilin donator i kemi tri projekte: projektin në lagjen "Dardania", projekti me të cilin ne jemi në vazhdimësi dhe të cilin ne e kemi debllokuar është Biblioteka e Qytetit dhe projekti i tretë është projekti i Stadiumit të Vogël, por ka edhe projekt tjera të vogla të cilat do t'i realizojmë me KE-në.

Po ashtu, në Gjilan prezente me investime është edhe Qeveria amerikane me të cilën në "Dardani" do të ndërtojmë çerdhen e fëmijëve, mandej Qeveria turke në shkollën "Abaz Ajeti" do ta ndërtojë çerdhen tjetër për fëmijë dhe shumë programe të tjera që janë në interes të Gjilanit. Siç po shihet, ne përparësi i kemi dhënë arsimit dhe infrastrukturës.

Në Shëndetësinë Primare, kemi arritur që ta rehabilitojmë pjesën më të madhe të infrastrukturës dhe në këtë degë të shëndetësisë, në bashkëpunim edhe me CARITAS-in, kemi punësuar një numër të mjekëve të rinj dhe të teknikëve të medicinës, dhe ky program do të ndihmojë që me

kuadër të kualifikuar do të mbulohen edhe punktet më rurale të Komunës si në Vërbicë të Zhegocit dhe Shurdhan. Kështu, po afrojmë shërbime shëndetësore sa më afër qytetarit tonë.

Po ashtu, vlen të përmendet, që këtë vit, partnerin më të madh financiar do ta kemi Qeverinë e Austrisë, e cila me Ministrinë e Financave të Kosovës, pritet për ta nënshkruar Marrëveshjen Teknike për marrjen e 12 milionë €, derisa projektet që do t'i hartojmë këtë vit dhe negociatat që i kemi bërë me Qeverinë e Austrisë janë për fillimin dhe përfundimin e rrjetit të kanalizimit në Gjilan. Është projekti kryesor i heqjes së lloçit dhe vadave (mënjanimi të ujërave të zeza), i cili do t'i përfshijë 54 km kanalizime, rregullimin e shtratit të lumit “Stanishorka” dhe përfundimin e fundit të shtratit të lumit “Mirusha”.

Në këtë projekt nuk hyn vetëm pjesa urbane e qytetit, por këtu hynë të gjitha fshatrat e Komunës së Gjilanit dhe të gjitha fshatrat rreth komunës së Gjilanit e të cilat janë ndotës përmes kanalizimeve në Gjilan, por edhe të fshatrave të komunave tjera në partneritet me to. Kjo është faza e parë e përmbylljes së kanalizimeve për Komunën tonë. Ndërsa, për fazën e dytë ne po punojmë me Qeverinë për ndërtimin e një impianti të ujërave të zeza dhe përfundimisht me këtë do të mbyllet procesi i ujërave të zeza. Lajmi më i madh për ne është se fillimi i këtyre punimeve i cili do të ndodhë në këtë vit, në mënyrë që projektet të realizohen brenda kalendarit të paraparë në afat prej një viti.

Po ashtu, presim që “Hidromorava” ta marrë dhe ta rehabilitojë rrjetin e ujësjellësit dhe poashtu jemi pajtuar që kompania në fjalë ta marrë për obligim edhe mirëmbajtjen e këtij ujësjellësi. Ne kemi investuar më parë në disa fshatra, por nuk është kujdesur askush për mirëmbajtje dhe kanë mbetur fshatrat dhe vendbanimet pa ujë. Rrejtë ekziston, por nuk është mirëmbajtur, kurse tash duhet të investojmë mjete shtesë për t' i rehabilituar të gjitha këto rrejtë të ujësjellësit ashtu që të furnizohet komuniteti me ujë, por në këtë rast duhet pasur parasysh edhe pagesën nga ana e komunitetit.

Në investime publike, këtë vit do të përfundojmë pjesë të asfaltimit të rrugëve, të ndërtimit të trotuareve dhe të rehabilitimit të rrugëve. Rrugë kryesore që do të ndërtohet është rruga Gjilan-Prishtinë dhe atë aksi i parë prej të ashtuquajturit tunelit deri te Penda e Livoçit, mandej prej Pendës deri te lagjja e Gllamës.

Në të njëjtën kohë, presim të fillojnë punimet prej Stacionit të Autobusëve në drejtim të Livoçit të Ulët dhe te tek udhëkryqi i Cërnicsë, loti i parë, kurse loti i dytë deri në Kllokot. Ky projekt është paraparë në mes të Ministrisë së Infrastrukturës, Komunës dhe Bankës Europiane për Zhvillim.

Po ashtu, pritet të fillojmë me ndërtim të Autostradës Dheu i Bardhë - Bunari i Përlepnicsë – Gllamë-Bresalc– Prishtinë, i cili do të jetë korridori më i madh që do të lidhet me autostradat ndërkombëtare. Obligim i ynë ka mbetur meremetimi i rrugës Malishevë - Uglar – Pogradjë, i cili projekt është investim i Komunës dhe Ministrisë së Infrastrukturës. Kjo rrugë, para luftës është ndërtuar me vetkontribut të këtyre fshatrave, prandaj ka ardhur koha që të investohet në këtë rrugë

dhe të hapet korridori deri te Dobrosini. Po ashtu, këtu ndërlihet edhe hapja e vendkalimit kufitar në Stanqiç për ta lidhur Gjilanin me Kumanovën.

Këto janë kryesisht projekte më të mëdha, kurse ne i kemi 1.2 milion € për rrugë në qytet, kryesisht rrugica dhe rrugë që kanë mbetur për pa u realizuar. Mirëpo, po aq mjete janë ndarë edhe për asfaltimin e rrugëve në fshatrat e komunës së Gjilanit, përveç në ato fshatra ku duhet të punojmë në kanalizim dhe ujësjellës e që do të mbesin në fazën e dytë për asfaltim të rrugëve dhe trotuareve.

Besoj se ky do të jetë vit i investimeve më të mëdha dhe do të vazhdojmë me disiplinë buxhetore dhe nuk do të ketë asnjë tolerancë të shpenzimit të buxhetit pa përmbushje të kriterëve të rrepta.

Investimet në bujqësi – investime në të ardhmen zhvillimore të komunës, me fokus të veçantë kultivimin e bimës së duhanit.

Ne i kemi edhe 200 mijë €, pa i harxhuar nga fondi i solidaritetit, që gjatë këtij viti do të fillojë meremetimi i shtëpive dhe ndërtimi i shtëpive të reja për rastet sociale në mënyrë që, asnjë familje nuk do të mbetet pa kulm mbi kokë.

Shpresojmë që viti 2016 të jetë një vit i mbarë për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjilanit!

Me respekt,

Lutfi Haziri

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRASTRUKTURË DHE BANIM

Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim, aktivitetin e punëve dhe detyrave të sajë gjatë vitit 2015 e realizoi-përfundoi me një sukses relativisht të mirë ka ende hapësirë për tu përmirësuar.

Bazuar në të drejtat dhe obligimet e drejtorisë nga kompetencat e sajë të cilat dalin nga Ligjet e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e ndryshme administrative si dhe në dispozitat ligjore të aplikueshme, të cilat i përkasin fushë veprimtarisë së Drejtorisë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim konform buxhetit të projektuar-planifikuar, nga ana e drejtorisë, për vitin kalendarik 2016, kanë planifikuar dhe hartuar këtë propozim të Planit të Punës

Qëllimet të cilat do të arrihen me realizimin e këtij plani të punës janë:

- Ngritja e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve
- Kompletimi dhe harmonizimi i infrastrukturës ligjore – akteve normative nga fushëveprimi i Drejtorisë, me Ligjet dhe Rregulloret
- Realizimin e sa më tepër projekteve me interes për qytetarët dhe Komunën në përgjithësi
- Mirëmbajtja e projekteve të realizuara
- Identifikimi i problemeve të infrastrukturës në përgjithësi dhe inicimi, ofrimi i zgjidhjeve të mundshme
- Krijimi i një ambienti më të sigurtë dhe më të shëndoshë për qytetarët
- Hartimi i Planit të punës dhe Planifikimi i Buxhetit për vitin 2016.

PLANIFIKIMI PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRASTRUKTURË DHE BANIM

Bazuar në të drejtat dhe obligimet e drejtorisë nga kompetencat e sajë të cilat dalin nga Ligjet e Kosovës

#	Aktiviteti	Perioda	Komente
1	Zbatimin e ligjeve, statutit, vendimeve dhe urdhëresave në fuqi	detyrë permanente	
2	Përgatitjen dhe hartimin e akteve të përgjithshme normative të drejtorisë	detyrë permanente	
3	Pranimin, shqyrtimi i kërkesave, lëshimin e akteve të caktuara normative për lëndët pranuar	detyrë permanente	Në QSHQ, arkivimi kryesor do të bëhet në atë qendër ndërsa në drejtori do të mbetet një arkivim interno i kërkesave të qytetarëve,
4	Riorganizimi i Drejtorisë-Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorisë	Janar- Mars	Për një funksionim edhe më të mirë dhe për ngritje të cilësisë së shërbimeve nevojitet një riorganizim i Drejtorisë . Ngritje e kapaciteteve profesionale dhe atyre teknike siç janë: Trajnime, kurse, seminare dhe këmbime përvojash; Pajisjet dhe teknologjia informative të programeve kompjuterike (arqikat, AutoCad , Sim trafik 8, programin GIS)
5	Zbatimi i Planit të Veprimit për Përmisimin e Shërbimit Mobiliteti sipas fazave me prioritet	detyrë permanente	Për ngritje të cilësisë së qarkullimit në komunikacion për ridizajnimin e udhëkryqeve, planifikimin e parkingjeve , rregullimin e trotuareve, lëshuarën në funksion të transportit urban .
6	Trafiku urban i miratur nga Ministria Financave 11 korrik 2013 projekteve propozimi nr.PPP-10-13		Ky projekt është me prioritet në Planin e Veprimit për Përmisimin e shërbimit Mobilitetit .
6	Përgatitja e rregullores për tërheqjeje me merimangë sipas ligjit mbi sigurinë në Komunikacion dhe udhëzimit administrativ të PK-së dhe aprovimin në Kuvend Komunal .	Shkurt - Korrik	Plotësimi i infrastrukturës ligjore - akteve dhe udhëzimeve në fuqi për nevojat e DSHPIB-së.
7	Plotësim ndryshimi i Rregullores për transportin rrugor (taxi dhe transport Urban – Periferik)	Shkurt-Korrik	Ndryshimi dhe plotësimi i rregullores me transportin rrugor sipas ligjit
8	Përgatitja dhe shpallja e ankandit publik për automjetet e konfiskuara të cilat nuk janë tërheq nga pronarët në afatin e caktuar.	Maj si dhe detyrë permanente pas 6muaj	Përshtetja e armodizimit të tyre si dhe na obligon udhëzimi që çdo 6 muaj të shpallim ankandet për shitjen e tyre të bëhet lirimi i autoparkut si dhe të bëhet hulumtimi i gjetjes së një sipërfaqe tjetër për parking

#	Aktiviteti	Periudha	Komente
9	Angazhimi për gjetjen e një hapësire publike komunale për automjetet e konfiskuara me merimangë –ose mundësia e rregullimit të infrastrukturës që është ekzistuese së paku mbulimi i sajë	Shkurt - dhjetor	Për shkak hapësirës së vogël dhe krijimi i një gjendje më të mirë për ruajtjen e automjeteve që nuk tërhiqen nga pronarët në afatin e caktuar.
10	Menaxhimi i autoparkut	Detyrë permanente	Mbajta e evidencës së veturave që kanë hyrë në autopark dhe lëshuara e veturave sipas kërkesave të palëve dhe koordinimi i punëve me kontraktuesin dhe PK-në
11	Angazhimi për gjetjen e një hapësire publike komunale për (treg të veturave)	Detyrë permanente	Pas i që për momentin tregu i veturave nuk menaxhohet nga Komuna
12	Angazhimi për gjetjen e një hapësire publike komunale për (treg të drunjve)	Detyrë permanente	Pas i që për momentin nuk kemi lokacion të caktuar nga Komuna
13	Bashkëpunimi me Drejtoritë e KK, zyrën Ligjore, zyrën e prokurimit, zyrën e auditimit, pra në përgjithësi me administratën komunale dhe me Kuvendin Komunal	detyrë permanente	Për çështje të ndryshme do të bashkëpunohet me organet adekuate, por me theks të veçantë do të angazhohemi në ngritjen e nivelit të bashkëpunimit .
14	Angazhime në përmbushjen e standardeve	detyrë permanente	Drejtoria do t'i kushtojë rëndësi të posaçme dhe permanente përmbushjes së standardeve për fushë-veprimtarinë e sajë bashkëpunim të madhë dhe raportim periodik në zyren për Integritet në lidhje me (emërtimi i rrugëve, vendbanimeve, shesheve, numrave të objekteve, mirëmb. së varrezave, transportit të udhëtarëve, sigurisë në komunikacion,
15	Bashkëpunimi me PK-në	detyrë permanente	Ky bashkëpunim do të fokusohet kryesisht në sigurinë në komunikacion, si dhe në krijimin e kushteve për qarkullim të lirë të qytetarëve dhe automjeteve në trafik, por edhe në kontrollimin e pjesëmarrësve në komunikacion përkatësisht në zbatimin e ligjeve në fuqi si dhe të Rregulloreve komunale.
16	Rritje e inkasimit të hyrave	detyrë perm.	Në bashkëpunim me qytetarët, PK-në, rritja e efikasitetit në punë e inspektionit komunal, etj.

#	Aktiviteti	Periudha	Komente
17	Mbikëqyrje permanente e projekteve të përhershme – vjetore, të mirëmbajtjeve	Gjatë kohës së implem. të projekt	Konsiderojmë se mbikëqyrja e projekteve të përhershme vjetore duhet të realizohet nga personeli i drejtoratit sepse kryesisht këto projekte janë projekte të mirëmbajtjeve.
18	Përgatitja e projekteve të përhershme kryesisht të mirëmbajtjeve.	Janar - Tetor	Projektet: mirëmbajtja e rrugëve të shtruara me zhavor në Komunë; mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara; shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve; shenjëzimi i emërimit të rrugëve, vendbanimeve, numrave të objekteve; mirëmbajtjen e ndriçimit publik; mirëmbajtjen dimërore të rrugëve dhe shesheve në Komunë; mirëmbajtja e semaforëve; mirëmbajtja e pastërtisë së qytetit, shesheve, parqeve, varrezave, monumenteve dhe përmendoreve, lumenjve etj.
19	Mbikëqyrja e projekteve kapitale të Komunës – mbikëqyrje në teren, organizim i takimeve të rregullta me mbikëqyrësin e KK në teren dhe kontraktuesin, etj.	Gjatë kohës së implem. të projekt.	Konsiderojmë se Drejtoria duhet të ketë qasje më të mëdha në të gjitha fazat për implementimin e projekteve ashtu që tash prej këtij viti të gjitha projektet e infrastrukturës kalojnë kompetencë e DSHPIB .
20	Inicimi i procedurave për realizimin e projekteve të filluara dhe të pa përfunduara	detyrë permanente	
21	Hulumtimi, identifikimi dhe inicimi i procedurave për zgjedhjen e disa pikave problematike - defekteve në lëmi të ndryshme të fushëveprimtarisë së drejtoratit (kanalizime, ujësjellës, komunikac., rrugë, ambient etj.)	detyrë permanente	
22	Bashkëpunimi dhe koordinimi me “Hidromoraven”, për furnizim të qytetarëve me ujë, mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, si dhe projekteve tjera të kësaj natyre	detyrë permanente	Posaçërisht rreth përgatitjeve për menaxhim të ujësjellsave dhe kanalizimeve rurale.

#	Aktiviteti	Perioda	Komente
23	Bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve me EKO "Higjiena" rreth grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave si dhe rreth mirëmb. higjienike të qytetit	detyrë permanente	
24	Bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve me PTK-në dhe KED-sin	detyrë permanente	Posaçërisht bashkëpunimi do të përqendrohet në mirëmbajtje të rrjeteve ekzistuese dhe planifikimeve për rekonstruim dhe zgjerim të rrjeteve përkatëse.
25	Përgatitja e projektit ideor mbi caktimin e kaheve të qarkullimit të automjeteve nëpër rrugët e qytetit	detyrë permanente	Për të siguruar një qarkullim të mirë të automjeteve në komunikacion kërkohet një analizë e përgjithshme e rrugëve të qytetit si një tërsi, për caktim adekuat të kaheve të lëvizjeve të tyre.
26	Bashkëpunimi me FSK-në, KFOR-in, OSBE-në, OJQ-të etj. rreth aktiviteteve dhe projekteve të DSHPIB	detyrë permanente	
27	Pjesëmarrje në vlerësim të ofertave për projekte të caktuara	Gjatë fazës vler. të proj.	
28	Pjesëmarrje në pranime teknike në cilësinë e anëtarit të komisionit apo edhe në cilësinë e përfaqësuesit të drejtoratit	Pas përfundimit të realizimit teknik të projekteve	Konsiderojmë se në të gjitha projektet të cilat janë projekte të drejtorisë por edhe ato të cilat drejtorja duhet t'i mirëmbajë pas pranimi teknik, në rastin kur në komision të pranimi teknik të punëve drejtorati nuk ka përfaqësues të vetin, atëherë përfaqësuesi i drejtoratit duhet të jetë prezent dhe të ketë mundësi t'i paraqesë vërejtjet nëse ka arsye për to.
29	Përgatitja dhe shpallja e ankandit për dhënie në shfrytëzim (lokalet, reklamat, hapësirat publike të KK-së)	Shkurt - Qershor	Sipas vendimit të KK - Gjilan
30	Përgatitje dhe organizimi i projekteve me karakter të përgjithshëm, siç janë aksionet për pastrimin e qytetit, lumenjve, siguria në komunikacion, debate me qytetarë etj.	Shkurt-Shtator	Debatet kryesisht do të kenë karakterin e vetëdijesimit qytetar për problemet të cilat ekzistojnë (kursimi i ujit të pijes, kujdesi ndaj ambientit, ruajtja - kujdesi për shenjat e komunikacionit, kujdesi për pjesëmarrësit në komunikacion etj.)

#	Aktiviteti	Periudha	Komente
31	Kërkimi i donacioneve për projekte të KK – DNSHP	detyrë perm.	
32	Hartimi i raporteve të punës dhe atë raporte javore, mujore por edhe periodike 3, 6, 9 dhe 12 mujore.	detyrë permanente	Përmes raporteve periodike do të kontrollohet edhe realizimi i planit të punës dhe realizimeve të planifikimeve buxhetore (të hyrat dhe shpenzimet).

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

OBJEKTIVI PËR NJË ARSIMIM SA MË CILËSOR E BASHKËKOHORË

- Zbatimi i reformave dhe kurrikulave për një sistem shkollor bashkëkohor.
- Nevojat e investimeve kapitale në infrastrukturën shkollore: hapësira, kabinete, fusha sportive, kuadër profesional drejtues, krijim të kushteve solide për zhvillimin e procesit mësimor, shërbime e mallra .
- Përmirësimi i kushteve të punës së punëtorëve arsimorë dhe ngritjen e pagave.
- Bashkëpunimi publiko privat me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimin dhe kushteve të punës në procesin edukativ arsimor.
- Siguria në shkolla dhe zbatimi i ligjshmërisë etj.

REALIZUESIT Bashkëpunues	Planifikimi	Korniza kohore		Mënyra e realizimit dhe rezultatet
DKA	Hartimi i planit një vjeçar i DKA-së	Fillimi i Janarit	2016	Harton Drejtoria e Arsimit
DKA dhe Shkollat	Analiza e suksesit të nxënësve	Janar	2016	Gjysmëvjetori i parë
DKA	Vizita të gjitha shkollave	8 janar deri më 16 janar	2016	Drejtori I DKA-së dhe zyrtarët kompetent
DKA	Planifikimi i buxhetit	Janar	2016	Sektori i Financave
DKA	Organizimi dhe mbajtja e garave të matematikës	Shkurt	2016	Garat organizohen nën mbikëqyrjen e DKA-së, organizatorët-ekspert-mësimdhënës së lëndës së matematikës.
DKA dhe Shkollat	Përgatitjet për ditën e mësuesit nga ana e shkollave	Shkurt	2016	Organizon drejtoria e arsimit-manifestim madhështor
DKA	Përgatitjet për mbajtjen e testit të arritshmërisë dhe maturës shtetërore	Shkurt	2016	DKA-ja dhe Shkollat
Drejtorja e Arsimit-shkollat	1. Përgatitjet -regjistrimi i nxënësve – fëmijëve parashkollor, klasat e I-ra dhe të X	Mars	2016	Grumbullimi i statistikave nga Drejtoria e Administratës publike-certifikatat e lindjes.
DKA-MASHT Menaxherët e institucioneve edukativo-arsimore	2 Përgatitja e konkursit për regjistrimin e fëmijëve në çerdhe , 3 Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë-regjistrimi i fëmijëve në reseed,formimi i klasave,shqyrtimi i ankesave të prindërve.	Prill -shtator komunitet kohor	2016	Ndarja dhe bashkëpunimi me drejtorët e shkollave sipas rajonit të vendbanimeve të fëmijëve. Komunikimi i vazhdueshëm me prindërit Komunikimi dhe raportimi zyrtar me MASHT.
DKA-ja	Procedimi në Kuvend i Rregullores për marrëdhënien juridike të punës	Mars		Komiteti i Arsimit dhe Seanca e Kuvendit Komunal

DKA	Shpallja e konkursit për drejtor dhe zv.drejtor të shkollave	Maj	2016	<i>Konkursi shpallet dhe organizohet nga drejtoria komunale e arsimit.</i>
Shkollat, DKA	Organizimi i maturës dhe semimaturës	Maj	2016	Shkollat dhe DKA
DKA dhe Shkollat	Mbledhja e shënimeve nga shkolla për numrin e nxënësve të klasave : IX,XII,XII XIII Caktimi I administruesve dhe vëzhguesve. Përcaktimi I qendrave të testimit Shpallja dhe raportimi I rezultateve.	Maj dhe Qershor	2016	<i>Udhëzimet e MASHT-it, drejtoret eshkollave,nxënësit ,administruesit,testet do të japin rezultatet përfundimtare për publikim e raportim.</i>
Aktivitete kulturore, sportive dhe edukative	Gara të diturisë,aktivitete sportive,debate për luftimin e dukurive negative e dhunës, siguria në shkolla, promovimi I të drejtave dhe përgjegjësi të nxënësve.	Maj dhe Qershor	2016	DKA-Psikologët, Pedagogët, Shoqëria Civile etj

*Takimi me menaxheret e të gjitha shkollave të Arsimit të Mesëm të Lartë dhe Konviktit...	Maj dhe Qershor	2016	Verifikimi i menaxherëve,ngritja e performances së tyre përmes trajnimeve në bashkëpunim me GIZ-in
*Takimi me menaxherët e Arsimit të Mesëm të Ulët dhe menaxheret e çerdheve në qytet dhe fshatra	Maj dhe Qershor	2016	Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe rezultateve të nxënësve, rendi dhe disiplina,vijueshmëria dhe ruajtja e pasurisë dhe ambientit shkollor. Bashkëpunimi me prindër, marrëdhëniet e mira..

Plani i punës për vitin 2016 - Komunat Gjilanit

Investime financiare dhe shlyerja e obligimeve (prioritare me nevoja) Investimet me prioritet ,sipas Planit Zhvillimor të Arsimit	Maj- Qershor	2016	Në bashkëpunim me shefin e sektorit të financave dhe me një përkujdesje racionale do të shikohen prioritetet në investime e pagesa ,duke pasur parasysh dietën buxhetore Analiza e suksesit të nxënësve maturantë,suksesit të testimeve të semimaturës dhe maturës. Analiza e suksesit të nxënësve në fund të vitit mësimor 2014- Raporti.
Komunikimi,raportimi, takimet e rregullta Sfida me Kurrikulen e re dhe fillimi I vitit të ri shkollor,pa klasat e XII-ta (kriteret)	Maj-qershor	2016	DKA dhe Bashkëpunimi i rregullt me Ministrinë e Arsimit
Përcjellja e punimeve të objekteve shkollore në ndërtim dhe planifikim të shkollave	Qershor - Korrik	2016	Projektet e realizuara,projektet në vazhdim,projektet e planifikuara,kërkesat dhe bashkëpunimi me donatorët,Drejtorinë komunale për zhvillim, MASHt-in për investime kapitale ,do të jenë përkujdesje e përhershme për realizim.
Shpallja e konkursit të rregullt për pranimin e kuadrit mësimor	Korrik	2016	Konkursi shpallet dhe organizohet në bazë të ligjit nga drejtoria e arsimit
Hartimi i kontratave të punës	Shator	2016	Kontratat hartohen dhe lëshohen nga drejtoria e arsimit.
Përgatitjet për fillimin e viti shkollor	Gusht	2016	Drejtoria e arsimit në koordinim me shkollat-përkatësisht me drejtorët e shkollave
Vizita të gjitha shkollave	Shator	2016	Drejtoria e arsimit së bashku me zyrtarët kompetent, për fillimin e vitit shkollor-mbarëvajtja e procesit
Përgatitja e suksesit të nxënësve për gjysmëvjetorin e parë	Dhjetor	2016	Drejtoria e Arsimit
Raporti i Drejtorisë Komunale të Arsimit	Dhjetor	2016	Drejtoria e arsimit

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Punët dhe tërë aktiviteti i DUPMM-së është i bazuar në Ligj dhe akte tjera nënligjore – udhëzime administrative të Kuvendit të Kosovës, vendimeve të Kuvendit Komunal-Gjilan.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit do të kryej detyrat dhe përgjegjësitë bazuar në përshkrimin e punëve dhe detyrave punuese të secilit puntor duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi si dhe rregulloret komunale .

Bazë e punës së Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit është Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës së Gjilanit, Ligji mbi procedurën Administrative, Ligji i planifikimit hapsinor, Ligji i ndërtimit, Ligji për mbrojtje të Mjedisit, Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale si dhe rregullore të ndryshme të Ministrisë së linjes dhe Kuvendit Komunal.

Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit aktivitetin e sajë punues e zhvillon përmes këtyre sektoreve:

- Sektori i përgjithshëm Juridik
- Sektori i Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Sektori i Lejeve
- Sektori i Inspeksionit
- Zyra e legalizimit

Sektori i Përgjithshëm Juridik

Aktiviteti	Afati kohor i zbatimit	Komente
Përcjellja dhe Zbatimi i Ligjeve rregulloreve, vendimeve dhe akteve tjera nënligjore nga fushëveprimi i drejtorisë	Detyrë permanente	Me rastin e miratimit të Ligjeve dhe akteve administrative
Rishikimi , përgatitja dhe hartimi i rregulloreve dhe akteve tjera për organizimin-sistematizimin e brendshëm dhe përshkrimin e punëve dhe detyrave të punës për drejtorinë	Detyrë permanente	Mvarësisht nga obligimet që dalin nga Ligjet e miratuara
Bashkpunimi , përgatitja dhe hartimi i projekt propozimeve të rregulloreve , projekt vendimeve , propozimeve dhe keshillave profesionale organeve të kuvendit të komunes , komiteteve ,	Detyrë permanente	Për kërkesat e adresuara në DUPMM

komisionet dhe trupat punuese të tij si dhe organeve ekzekutive		
Përgatitja , percjellja dhe zbatimi i vendimeve dhe procedurës lidhur me hartimin dhe miratimin e planeve urbanistike, Prrh-ve në proces	Detyrë permanente	Mvarsisht nga lloji i aktivitetit
Rexhistrimi dhe perpunimi i kërkesave për trajnimin e ndertimeve pa leje	Detyrë permanente	
Përgatitja e propozim vendimeve për revidimin e planeve ekzistuese , përketesht hartimin e planeve hapinore për zonat që do të përzgjidhen nga organet kompetente të komunës		
Rishikimi dhe plotësimi i vendimit për taksa dhe tarifa për leje ndertimi dhe leje mjedisore		
Evidentimi-protokolli i lendeve-kërkesave		
Evidentimi intern dhe ekstern i lendeve dhe shkresave		
Perpunimi , formulimi , nxjerrja dhe leshimi i lejeve të ndertimit, lejeve mjedisore , lejeve të legalizimit , vendimeve , konkluzave , lajmrimeve , njoftimeve etj nga fushëveprimi i drejtorisë.		
Radhitja , ndarja , ruajtja dhe arkivimi i lendeve		
Ndihmesa stafit të drejtorisë dhe organeve tjera lidhur me organizimin e takimeve , tubimeve debateve dhe formave tjera të komunikimit me institucionet, hartuesit e planeve urbanistike , grupet punuese , qytetaret e zonës urbane dhe rurale , shoqërinë civile , komunitetin e biznesit , mediave etj , lidhur me hartimin e planeve urbanistike		
Raportimet e punës	Javore, mujore tre mujore gjashtë mujore, nëntë mujore dhe vjetore	

Hartimi i kërkesave , propozim vendimeve , formulareve dhe shkresave nga fusheveprimi i drejtorise		
Mbajtja , perpunimi , evidentimi dhe ruajtja e procesverbaleve nga debatet, takimet e shqyrtimet , shiqimet e planeve urbanistike		
Pergatitja e lendes arkivore të drejtoris dhe lendeve tjera në drejtori		
Punë të tjera lidhur me fusheveprimin e drejtorisë		

Sektori i Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit

Aktiviteti	Afati kohor i zbatimit	Komente
Hartimi i detyrave projektuese për planet rregulluese të hollësishme për zona të caktuara .		Sipas prioriteteve, kërkesave të qytetareve dhe zhvillimeve në teren.
Nxjerrja e ekstrakteve nga planet në fuqi si dhe dhënja e tyre	Detyrë permanente	Për kërkesat e adresuara në sektor
Ekstrakteve për parcelim sipas PRRU	Detyrë permanente	Për kërkesat e adresuara në sektor
Propozim zgjidhje të ndryshme mikro dhe makro urbane në kuadër të planeve në fuqi	Në fund të muajit Shkurt	Mvarsisht nga kërkesat e zyres së projekteve – investimeve komunale
Përpilimi i detyres projektuese për revidimin e PRRH "Qendra 1 "	Muaji Shkurt	Revidim
Hartimi i detyres projektuese për revidimin e PZHK-së	Muaji Mars	Revidim
Vazhdimi i procesit për hartimi i PRRU "Qendra 4", mbajtja e takimeve konsultative me qytetar –prezentimi i skenarve –përzgjedhja e skenarit kryesor, shpallja e diskutimit publik si dhe hapat në vijim deri në miratim	Në fund të muajit Prill	Vazhdimi i procesit
Vazhdimi i procesit për hartimi i PRRU "Zabeli", mbajtja e takimeve konsultative me qytetar –prezentimi i skenarve – përzgjedhja e skenarit kryesor, shpallja	Në fund të muajit Maj	Vazhdimi i procesit

e diskutimit publik si dhe hapat në vijim deri në miratim		
Monitorimi i PRRH "Fidanishte 2"	Perfundimi i muajit Qershor	Vazhdimi i procesit
Monitorimi i PRRH "Qendra 2"	Perfundimi i muajit Nëntor	Vazhdimi i procesit
Monitorimi i PRRH "Qarku 3"	Vazhdimi vitin 2017 (përfundimi Mars 2017)	Vazhdimi i procesit
Monitorimi i PRRH "Qendra 1"	Vazhdim në vitin 2017 (përfundimi Mars 2017)	Vazhdimi i procesit
Vlerësimi i stafit për punën e vitit – përgaditja e raporteve për zyrë të personelit.		
Raportimet e punës për periudhat e nevojshme kohore	Javore, mujore tre mujore gjashtë mujore, nëntë mujore dhe vjetore	
Pjesëmarrje aktive në vlerësimin e ofertave të projekteve investive nga komuna		

Sektori i Lejeve

Aktiviteti	Afati kohor i zbatimit	Komente
Ekstrakt nga Planet Rregulluese Urbane, PZHU dhe PZHK	Detyrë permanente	Për kërkesat e adresuara në sektor
Caktimi i kushteve ndërtimorev me të cilat lejohet leja e ndërtimit sipas Ligjit të Ndërtimit dhe PRRU në fuqi.	Detyrë permanente	Për kërkesat e adresuara në sektor
Caktimi i kushteve ndërtimore të kërkesave për objektet të karakterit të përkohëshëm sipas ligjit në fuqi	Detyrë permanente	Për kërkesat e adresuara në sektor
Caktimi i kushteve urbanistike –pëlqimet për parcelim sipas dispozitave të përcaktuara me PRRU	Detyrë permanente	Për kërkesat e adresuara në sektor

Kontrollimi dhe vertetimi i dokumentacionit teknik i projekteve kryesore dhe fazave tjera të kërkuara sipas ligjit të ndërtimit	Detyrë permanente	Me rastin e vlersimeve të projekteve kryesore kërkohej vlersimi profesional i profileve të caktuara për secilen fazë
Llogaritja e sipërfaqeve të objekteve të projektuara sipas rregulloreve komunale në fuqi-ligjit të ndërtimit	Detyrë permanente	Kërkuesi merr konfirmimin për pagesë
Matjet gjeodezike të ngastrave kadastrale dhe caktimi i pikave të vësirës rregulluese dhe ndërtimore	Detyrë permanente	Pas marrjes së leje ndërtimit me kërkesën e përcaktuar të obliguar për caktimin e pikave në terren
Pjesëmarrje në përgatitjen dhe përpunimin e rregullores për taksat, ngarkesa dhe gjëra komunale për vitin 2016	Dhjetor 2016	Me rastin e miratimit në kuvendin e komunës, rregullorja hyn në fuqi
Përpunimi dhe përcjellja e rekomandimeve dhe propozimeve të rasteve që duhet të kalojnë në trupat e kuvendit komunal	Detyrë permanente	Për kërkesat e adresuara në sektor
Pjesëmarrje aktive në hartimin e propozim-vendimeve mbi taksat administrative për leshimin e leje ndërtimit dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës	Tetor-Dhjetor 2016	Sipas U.A nr.22/2012
Pjesëmarrje Aktive në procesin e legalizimit duke bazuar në ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje	Data kur ligji ka hyrë në fuqi 5 shkurt 2014 dhe data në të cilën ligji pushon të jetë në fuqi	Ligji nr.04/L-188 dhe U.A MMPH-nr.18/2014
Kshillimet e qytetarëve në lidhje me kushtet dhe procedurat për paisje me leje ndërtimore	Detyrë permanente	Për kërkesat e adresuara në sektor
Vlersimi dhe monitorimi i dinamikës së zhvillimeve në terren – ndërtimet e zhvilluara në raport me kërkesat dhe planin rregullues	Detyrë permanente	Me kërkesën e drejtorisë
Bashkëpunimi me sektorët brenda drejtoratit dhe drejtorive komunale	Detyrë permanente	Me kërkesën e drejtorisë
Bashkëpunon dhe jep ndihmë profesionale me Kuvendin e Komunës, trupat punuese të tij dhe organet tjera,	Detyrë permanente	Me kërkesën e drejtorisë

ose kërkojnë mendime profesionale për qështje nga fushëveprimin i Drejtorisë		
Raportimet e punës për periudhat e nevojshme kohore	Javore, mujore , tre mujore, gjashtë mujore dhe vjetore	Me kërkesën e drejtorisë
Raporti i punës për pagesat të komunalive për leje ndërtimi për objektet individuale dhe objekte kolektive banesore-afariste për vitin 2016	Javore, mujore tre mujore gjashtë mujore, nëntë mujore dhe vjetore	Me kërkesën e drejtorisë

Sektori për Mbrojtje të Mjedisit

Aktiviteti	Afati kohor i zbatimit	Komente
Caktimi i kushteve mjedisore në kuadër të PZHK dhe PZHU	Detyrë permanente	Varsisht nga kërkesat e adresuara në sektor
Caktimi i kushteve për paisje me leje mjedisore	Varsisht nga koha e përcaktuar me udhëzimin administrativ të MMPH	
Pjesëmarrje aktive në përgatitje në shënimin e ditëve të përcaktuara me kalendarin mjedisor (dita e ujit , tokës, mjedisit)		
Vlerësimi dhe monitorimi i ndotësve të mjedisit (ujë, tokë, ajër)	Detyrë periodike	
Mirëmbajtja e databazës dhe pjesës grafike si dhe azhurnimi në procesin e planifikimit të GIS	Detyrë permanente	
Bashkëpunimi me sektorët tjerë brenda drejtorisë dhe me drejtoritë komunale	Detyrë permanente	
Raportet e punës për periudhat e nevojshme kohore	Javore, mujore tre mujore gjashtë mujore, nëntë mujore dhe vjetore	

PROJEKTET ME PRIORITET TË DUPMM PËR PERIUDHË JANAR-DHJETOR 2016

Gjatë kësaj periudhë Janar-Dhjetor 2016 Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit do të ketë këto prioritete:

- Shqyrtimin e drejtë dhe efikas të kërkesave të ndryshme të qytetarëve
- Hartimi i elaboratit të shpronësimeve –interesave publike brenda PRRU-të aprovuara (sipas nevojave)
- Implementimin sa më efikas në teren të PRRU -ve të miratuara.
- Hapjen e korridoreve të reja – rrugëve lidhëse dhe përmbledhëse dhe hapësirave tjera publike në kuadër të PRRU
- Caktimi i lokacionit dhe propozim zgjidhja e planit të varrezave të qytetit
- Përfundimi i projektit të ARIS dhe monitorimi i tij në të ardhmen (sistemi i adresave)
- Përcjellja e procesit të zbatimit të Ligjit për trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, Nr. 04/L-188
- Regjistrimin e objekteve të ndërtuara pa leje
- Riorganizimi i drejtorisë sipas ndryshimeve statutare
- pjesëmarrje aktive në komisione të ndryshme sipas kërkesave

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI

Synimi kryesorë i DBP-së është që përmes përkrahjes së fermerëve në forma të ndryshme të ndikojë në:

- Krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë.
- Rritjen e prodhimtarisë bujqësore.
- Hapjen e vendeve të reja të punës dhe
- Zvoglimin e importit.

SEKTORI I BLEGTORISË

1. Gjendja aktuale

Fermerët ballafaqohen me shumë sfida si: Strukturën racore, mungesën e infrastrukturës stallore, mungesa e ushqimit, mekanizimit jo të plotë bujqësorë etj. Edhe ato ferma të ndërtuara gjatë këtyre viteve janë me mungesë infrastrukturore si mungesë e dritareve të mjaftueshme dhe jo adekuate, dyer të papështashme, mungesë ventilimi, dysheme, boxe dhe grazhde jo adekuate, mungesë të ujëpërseve automatike, pa gropa septike për plehun e lëngët që reflektojnë efektet anësore në ambient, mungesë të gropave për deponim të plehut të ngurtë dhe mungesë të paisjeve të qumështit si bidona dhe llaktofrizë etj.

Nënspektori i gjedheve

Gradualisht është duke u zhvilluar, nga fondi total i gjedheve prej 7500 krerë, 4500 janë lopë qumështi. Racë e pastërt qumështore janë shumë pak, ku kemi 10 ferma që mbarështojnë lopë të racës së pastërt, ndërsa afër 200 miniferma mbarështojnë metis të racave të ndryshme si hollishtajn i kuq, hollishtajn i zi, simental etj.

Plasmani i qumështit është i mirë dhe prodhuesit e qumështit nuk kanë probleme në këtë drejtim, një pjesë dërmuese e tyre qumështin e shesin në qumështore rreth 150 ferma dhe pjesa tjetër në tregun joformal.

Ferma të specializuara për trashje të viqave në Komunë janë 9, ndërsa fermerët tjerë rrisin viqat mashkuj prej 3 deri në 9 mujsh dhe i plasojnë në treg.

Për mbarështuesit e viqave për trashje poashtu ka një treg të mirë si në thetore të cilat kanë kapacitete të pranojnë të gjitha kafshët për trashje.

Kapacitetet prodhuese për qumësht gjedhi janë: 30 % në raport me konsumin.

Kapacitetet prodhuese për mish gjedhi janë: 10 % në raport me konsumin.

Aktivitetet:

1. Do të kërkojmë mundësin e furnizimit të bujqëve me lopë qumështore të racave të pastërta, në partneritet me donator të ndryshëm dhe me fermerë.
2. Paisja e Blegtorve me mjelse lëvizëse dhe bidona të qumështit
3. Mbështetja e fermerëve për aplikim në skemen e subvencioneve për krerë dhe granteve të MBPZHR.

Nënsektori i kafshëve të imta (dhenëve dhe dhive)

Komuna ka resurse të mira për mbarështimin e kafshëve të imëta: Kullosa, livadhe dhe tokë bujqësore për të plotësuar nevojat e tyre ushqyese.

Kemi 103 fermerë që mbarështojnë dhenë dhe numri total i tyre në Komunë është 6286 krerë. Racat dominante janë metisët e deleve të Sharrit dhe Virtembergut. Infrastruktura stallore është e dobët dhe nuk kanë treg të organizuar për qumësht, qengja dhe për lesh.

Kapacitetet prodhuese janë 20 % në raport me konsumin.

Numri i fermave të dhive është 100 me 1571 krerë. Dominojnë racat ballkanike dhe diku rreth 20 % e dhive janë të racave Alpine si ajo e Francës, Zvicrës etj.

Komuna, DBP në bashkëpunim me CARE ka ngritë një pikë grumbulluese dhe përpunuese të qumështit të dhisë në Bresalc e cila ka bërë kontratë me 20 fermerë të cilët e dërgojnë qumështin në këtë pikë, dhe pjesa tjetër e fermerëve pregadisnin djath në ekonomit e veta shtëpiake dhe e shesin në treg.

Infrastruktura stallore është e dobët dhe nuk kanë treg të organizuar për qumësht dhe djath. Kapacitetet prodhuese janë 20 % në raport me konsumin.

Aktivitetet:

1. Organizimi i një tregu të përbashkët me tërë infrastrukturën e duhur përcjellëse për shitjen e kafshëve.
2. Krijimi i kushteve në tregun e gjelbërt për prodhuesit vendor për shitjen e bylmetrave.
3. Mbështetja e blegtorëve për aplikim në skemen e subvencioneve për krerë dhe granteve të MBPZHR.

Bletët

Komuna numron 245 bletarë me 4246 shoqëri. Në komunën e Gjilanit ka kushte ideale për tu marrë më këtë veprimtari nevojat e konsumatorëve plotësohen vetëm me 20 %.

Infrastruktura e bletishteve është e dobët sepse bletarët shumica e tyre kanë shtëpiza të vjetra dhe mungesë e paisjeve tjera në bletore si shkrirëse dylli, centrifuga etj.

Aktivitetet:

1. Paisja e të gjithë bletarëve me paisjet elementare për bletishtë.
2. Paisja e 50 bletarëve me centrifuga për nxjerrjen e mjaltit.
3. Mbështetja e bletarëve për aplikim në skemen e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR.

SEKTORI I LAVËTARISË DHE PERIMKULTURËS

Komuna e Gjilanit posedon kushte të përshtatshme klimatiko – tokësore, që mundësojnë organizimin e prodhimit të suksesshëm të kulturave lavëtare dhe perimore. Përpos kulturave bazike Grurit dhe Misrit, tani janë duke u rritur sipërfaqet në llogari të kulturave perimore si në ambient të hapur ashtu edhe në ambient të mbyllur.

- Sipërfaqet e mjellura me grurë 3000 ha
- Sipërfaqja e mbjellur me elb 100 ha
- Sipërfaqja e mbjellur me tërshër 150 ha
- Sipërfaqet e mbjellura me miser 2000 ha
- Sipërfaqet e mbjellura me patate 150 ha
- Sipërfaqet që mbillen me kultura perimore në fushë të hapur 350 ha
- Sipërfaqet në ambiente të mbyllura (Serra) 25 ha.
- Fasule monokulturë 20 ha.

Plotësimi sa më i madh i nevojave vetanake me komponentën ushqyese është synim i yni dhe mund të arrihet përmes rritjes së rendimentit mesatar. Paketa teknike për arritjen e kësaj përfshin farën e kualitetit të lartë, mbjelljen e mekanizuar, zbatimin përkatës të plehrave dhe mbrojtja e bimëve me kemikale.

Kosova importon sasi të konsiderueshme të miellit të grurit edhe pse egzistojnë kushtet për prodhimin e tij në vend. Në bazë të rendimenteve të grurit të korrura gjatë viteve të fundit komuna e Gjilanit i plotëson nevojat e popullatës me grurë rreth 50%.

Aktivitetet:

1. Subvencionimi i mbjelljeve pranverore me farë misri.
2. Subvencionimi i mbjelljeve vjeshtore me farë gruri.
3. Mbështetja e 100 fermerëve me mekanizim përcjellës për bujqësi (Spërkatëse, freza, piatore, kositëse rotative dhe grumbulluese të sanës).
4. Rregullimi i infrastruktures rrugore (trajtimi i rrugëve fushore)

5. Mbështetja e fermerëve për aplikim në skemen e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR.

Kultivimi i perimeve kërkon angazhim më të madh të fuqisë punëtore, ashtu që ndikon në punësim për disa herë më tepër se sa lëmitë tjera të bujqësisë. Shtimi i prodhimit të perimeve, do të ndikonte në furnizimin e tregut dhe zbutjen e deficitit tregtar të tyre.

Shumica e kulturave perimore (domatja, speci, trangulli etj.) kanë origjinë nga viset e nxehta. Për këtë arsye, në fushë të hapur kultivimi i tyre është i mundur për një periudhë të shkurtër kohore.

Në fushë të hapur kryesisht kultivohen shalqini, pjepni, lakra, qepa, hudhra, karrota etj. perime këto që kanë vegjetacion më të shkurtër.

Në kushte tona klimatike, prodhimtaria e perimeve ka karakter sezonal. Prandaj, prodhimtaria në ambiente të mbyllura, paraqet një mundësi të mirë për ndryshimin e këtij karakteri sezonal.

Në vitet e fundit tek ne, vërehet një orjentim i madhë i prodhuesve për këtë mënyrë të kultivimit të perimeve. Intensifikimi i mëtejshëm i prodhimtariisë së perimeve në ambiente të mbrojtura do të eliminonte karakterin sezonal të prodhimtariisë dhe do të mundësonte furnizimin e vazhdueshëm të tregut me perime të freskëta gjatë tërë vitit me çmime të arritshme për konsumatorin.

Për nga aspekti ekonomik, kultivimi i perimeve në serra paraqet mënyrën më intensive me ç'rast arrihen rendimente mjaft të larta dhe afate kohore të planifikuara.

Plotësimi i nevojave të popullatës me perime sillet rreth 30-40 %.

Aktivitetet:

1. Paisja e 10 perimtarëve me serra komerciale me sipërfaqe 300 m²
2. Paisja e 20 perimtarëve me serra gjysëm-komerciale me sipërfaqe 150 m²
3. Mbështetja e perimtarëve për aplikim në skemen e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR.

SEKTORI I PEMËTARISË

Gjilani njihet si regjion pemëtar, duke ju faliminderuar kushteve klimatiko – tokësore të përshtatshme, që mundësojnë organizimin e prodhimtariisë së suksesshme pemëtare. Përveq kushteve natyrore, egziston edhe zingjiri përpunues dhe ai ruajtës mjaft i konsoliduar me fuqi të mjaftueshme punëtore, kështu që me sukses mund të kultivohen shumica e llojeve të pemëve kontinentale. E konsiderojmë me interes për bujqësinë komunale, që edhe pemëtaria të trajtohet me prioritet zhvillimor.

Argumentat në favor të këtij prioriteti janë të shumtë, por më kryesorët do të ishin:

1. Kostoja e prodhimit për njësi të pemet, si ato farore, bërthamore dhe pemët e imëta, është për dy e më tepër herë më e vogël se sa qmimi i shitjes së produktit;
2. Shtimi i prodhimit të frutave, do të ndikonte në furnizimin e tregut dhe zbutjen e deficitit tregtar të tyre.
3. Kultivimi i pemëve kërkon angazhim më të madh të fuqisë puntore, ashtu që ndikon në punësim për disa herë më tepër se sa lëmitë tjera të bujqësisë.

Gjendja e pemëve të vjetra që gjenden në zonat rurale dhe që janë në kultivim ekstensiv është jo e mirë, tani kryesisht janë në fund të jetëgjatësisë së tyre dhe në proqes të tharjes, andaj është me interes ripërtirja dhe investimi në pemtore të reja.

Sipas shenimeve që disponojm, në teritorin e komunës së Gjilanit me pemë frutore janë të mbjellura gjithsejtë rreth 220 ha kryesisht në kultivim gjysëm intensiv dhe intensiv.

Synimi ynë është ngritja e pemishteve të reja me lloje, variete dhe nënshartesa të përshtatshme për kushtet tona.

Sasia e nevojshme ditore e konsumit të frutave të pemëve frutore për një person është rreth 200 deri 250 gr, ndersa e përlogaritur për një vit është rreth 100 kg.

Nga kjo mund të konkludohet se nevojat e tregut të Gjilanit për fruta pemësh në nivel vjetor janë mbi 1000 vagon ose (100000 banor x 100 kg = 10 000 000 kg ose 1000 vagon), e që do të përgjigjej sipërfaqeve me pemishte prej 400 deri 500 ha, me një mesatare për ha prej 20 000 deri 25 000 kg).

Nga kjo që u tha mund të konstatohet se për plotsim të nevojave të tregut të komunës së Gjilanit me pemë frutore është e nevojshme që të ngriten edhe rreth 200 deri 300 ha, ndersa kur kihet parasysh mundësia e përpunimit si dhe eksporti i tyre atëher nevojat për investime janë shumë më të mëdha.

Vëmendje e veçantë do të kushtohet pemëve të imta si: Mjadrës, manaferrës dhe dredhzës, si dhe masave për mbrojtjen e tyre.

Aktivitetet:

1. Ngritja e 10 ha me mjedër.
2. Ngritja e 10 ha me mollë.
3. Mbështetja e pemtarëve për aplikim në skemen e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR

AKTIVITETET TJERA TË PËRGJITHSHME QË PLANIFIKOHËN NË DREJTORIN E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË JANË:

- Kontrollimi i cilësisë së ushqimit me prejardhje shtazore
- Përkujdesi për shëndetin e kafshëve shtëpiake
- Reduktimi i qenëve pa pronar
- Organizimi dhe monitorimi i fushatës së korrje- shirjeve
- Rregullimi i hapsirës së gjelbërt në institucione publike
- Ruajtja e pyjeve nga prerësit ilegal
- Pregaditja e ankandit për prerjen e masës drusore në pyjet publike
- Pastrimi dhe pararrallimi i pyjeve publike
- Darka e Lamës dhe
- Manifestimi farmeri i vitit 2015.

Planifikimi i Buxhetit për vitin 2016						
Lloji i Investimit	Komuna	Donatori	Fermeri	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithësejtë / €
Ngritja e 10 ha me Mjedër Implementimi, Shkurt – mars	30,000.00			30,000.00		30,000.00 €
Furnizimi me farë misri Implementimi, Mars – prill	15,000.00			15,000.00		15,000.00 €
Furnizim i 50 bletrëve me Centrifuga për nxjerrjen e mjaltit. Implementimi Prill-Maj	10,000.00			10,000.00		10,000.00 €
Paisja e Blegtorve me mjelse lëvizëse dhe bidona të qumështit Implementimi, Qershor – korrik	10,000.00	2,500.00	2,500.00	15,000.00		15,000.00 €
Shtrimi i rrugëve të arave me zhavor Implementimi, Qershor – tetor	100,000.00				100,000.00	100,000.00 €
Mekanizim Bujqësor Implementimi, Korrik – gusht	50,000.00		10,000.00	60,000.00		60,000.00 €
Serra komerciale 10 x 300 m ² dhe Serra gjysëm-komerciale 20 x 150 m ² Implementimi, Gusht - shtator	30,000.00		7,500.00	37,500.00		37,500.00 €
Furnizimi me farë gruri Implementimi, Shtator - tetor	45,000.00			45,000.00		45,000.00 €
Gjelbrimi i sipërfaqeve në institucionet publike Implementimi, Tetor - nëntor	20,000.00				20,000.00	20,000.00 €
Darka e Lamës - 28.12.2016	1,000.00				1,000.00	1,000.00 €
Gjithsej:	310,000.00	2,500.00	20,000.00	212,500.00	120,000.00	332,500.00 €

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në kuadër të Komunës së Gjilanit është e themeluar me qëllim të ndërmarrjes së aktiviteteve për të ngritur nivelin e zhvillimit ekonomik lokal, në komunë. Mision ky, kyç për përmirësimin e jetesës së qytetarëve si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara në fushën e zhvillimit ekonomik lokal.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik punon sipas planit të punës të përgatitur në mënyrë profesionale, me qëllim të zhvillimit ekonomik lokal, pasi që jemi të bindur se zhvillimi ekonomik lokal mundëson përmirësimin e mirëqenies së të gjithë qytetarëve që jetojnë në Komunën e Gjilanit.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në kuadër të Komunës së Gjilanit ka për qëllim të ndërmarrë aktivitete të cilat ndikojnë në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik lokal, në kuadër të komunës, duke pasur mision përmirësimin e jetesës së qytetarëve si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara në fushën e zhvillimit ekonomik lokal.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë muajit janar – shtator 2015 ka vazhduar me aktivitete të cilat kanë ndikuar në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik lokal në komunë, e gjitha duke përkrahur biznese të vogla e të mesme që të aplikojnë në thirrjet për grante gjë që po rezulton sukses.

Periudha – e perfshir ne muaj													
Nr	Përshkrimi i obligimeve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
01	THEMELIMI I NDËRMARRJES SË RE LOKALE “TREGU”	✓	✓										
	Njoftim i komiteti për Politikë dhe Financa		✓										
	Aprovim në asamblen Komunale në Gjiilan			✓									
	Aprovimi nga MZHE – Minsitria e Zhvillimit Ekonomik për themelimit të Ndërmarrjes “Tregu”				✓								
02	ORGANIZATA QEVERITARE - GIZ												
	Aprovimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave			✓									
	Faza II projekti “Shkollat Riciklojn”ku përfshin shkollat në për fshatra			✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
03	CULTURAL HERITAGE ËITHOUT BORDERS (CHËB) (Ndërtimi i urës afër Kalasë së në fshatit Pogragjë – inagurimi)					✓							
	Fizibiliteti për zonën turistike “Liqeni i Livoqit”			✓	✓	✓	✓	✓					

04	PARTNERITETI PUBLIKO PRIVAT			✓									
	Fillimi i implementimit të projektit (Kompleksi i shkollave të mesme)				✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
05	PARTNERITETI PUBLIKO PRIVAT												
	- Palestra sportive “Bashkim Selishta”				✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
	- Ndërtimi i objektit të çerdhës së fëmijëve në lagjen “Dardania”				✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
	- Objektet përcjellëse (stalla e lopëve, sera, plantacioni, depoja ftohëse për pemë dhe perime) të shkollës së mesme bujqësore “Arbëria				✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
06	HARTIMIN E PLANIT TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIM SOCIO- EKONOMIK LOKAL												
	Është identifikuar organizata me të cilat mund të bashkëpunojmë USAID-it programit AKT (Advancing Kosovo Together)			✓	✓	✓	✓	✓	✓				

	Formimi i ekipes, aprovimi dhe fillimi i aktiviteteve				✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
07	AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN KOSOVO				✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
	Formimi i Këshilli Konsultativ Lokal				✓	✓							
	Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit për implementimin e MiM dhe zgjerimin e Këshillit Konsultativ Lokal edhe me biznese tjera				✓	✓							
08	TARIFAT Implementimi i Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa			✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
09	MINISTRIA E FINANCAVE PRISHTINË Kerkese per Ministrine e Financave te Kosoves dhe Ministrise se Financave te Austrise (Soft Loan Project)	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
	Përgatitja e projekteve			✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
10	INKUBATORI I BIZNEESIT												

	Implementimi i projektit Programi KYDP (Kosovo Youth Development Project) dhe Qendra Rinore	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
	Lirimin e hapësirave Agjencise Pyjore e Kosoves Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarise	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
11	Bashkëpunimi me komunitetin ndërkombëtarë (USAID/ATK, Komisionin Evropian, GIZ, KfE, TIKA, HELP, Cultural Heritage Without Borders si dhe programe tjera)	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
12	Bashkëpunimi me Qeverinë e Kosovës (Ministrit e linjës si MAPL, MF, MZHE, MTL..)	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
14	Organizmi i Panairit Regjional "Gjilani 2016"							✓	✓				
15	Organizimi i aktiviteteve "Ditët e Mërgatës"							✓	✓				

Misioni:

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka si mision mbështetjen e procesit të hartimit dhe zbatimit të politikave të qeverisë lokale, për një zhvillim të integruar të sektorëve prioritarë të ekonomisë, përmes dhënies prioritet dhe rritjes së efektivitetit të investimeve publike, nxitjes së bashkëpunimit lokal dhe rajonal që ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara në fushën e zhvillimit ekonomik lokal.

Objektivat kyçe të punës:

- Në bashkëveprim me Kryetarin e Komunës dhe Institucionet tjera Komunale, do të krijojmë një kornizë të përshtatshme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror,
- Hartimi e strategjisë zhvillimore lokale në përputhje me strategjinë regjionale dhe atë qendrore, duke përfshirë të gjithë sektorët e ekonomisë, si në aspektin afatshkurtër edhe në atë afatgjatë,
- Hartimin e politikave zhvillimore dhe marrjen e masave të përshtatshme për të nxitur më tutje zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Komunës,
- Hartimin e planeve dhe nxitjen e investimeve të jashtme me qëllim të realizimit të projekteve komunale,
- Hulumtimin e mundësive për të siguruar donacione dhe burime të tjera financiare,
- Hartimin e programeve sipas veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomik, dhe përgatitjen e propozimeve konkrete për projekte të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorëve të veçantë,
- Ofrimin e trajnimeve dhe dhënien e këshillave për bizneset lidhur me mundësit për të investuar kapitalin e tyre në veprimtarit prodhuese dhe ku janë mundësit më të mira për të kthyer investimin e bërë dhe avancimi i bizneseve të tyre,
- Ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e bizneseve - Qendra e Regjistrimit të Bizneseve
- Hartimin e planit komunal për energji dhe efikasitet (PKEE) dhe përshtatja me nivelin lokal në përputhje me politikat kombëtare AKEE si dhe direktivat e BE-së;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i projekteve lidhur me Partneritet Publiko Privat,
- Bashkëpunimin me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe resorëve tjerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës rreth mundësive dhe koordinimit të aktiviteteve lidhur me realizimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal,
- Bashkëpunimin me Institucionet Ndërkombëtare dhe organizatave të ndryshme financiare për projekte të ndryshme zhvillimore,
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me Organizatat jo Qeveritare që mund të përkrahin me projektet ideore të cilat kanë në fokus promovimin dhe zhvillimin ekonomik lokal ,
- Bashkëpunimi i ngushtë me bizneset e Komunës lidhur me përmirësimin e kushteve për biznes përmes mbështetjes së njëra tjetrës,

- Koordinimi dhe mbikëqyrja e realizimit të projekteve – bashkëfinancimi i projekteve nga Donatorët, Qeveria dhe Komuniteti - Zotimet ndaj marrëveshjeve
- Përcjellja dhe zbatimi i politikave dhe programeve zhvillimore, planeve vjetore dhe strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal dhe regjional - duke përfshirë edhe bashkëpunimin ndërkufitarë
- Organizimin e konferencave të ndryshme për mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik të Komunës dhe regjionit,
- Organizimin e panairove për promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve,
- Komunikimin e vazhdueshëm me diasporën që të jenë të informuar lidhur me lehtësirat, planet zhvillimore, projektet dhe mundësitë praktike që ofron Komuna në raport me investitorët e mundshëm,
- Promovimin e turizmit në aspektin ekonomik lokal dhe
- Fuqizimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me Diasporën (Mërgatën) dhe promovimin e bizneseve nga Diaspora dhe mundësitë e investimeve në Komunë për bizneset e Diasporës

Të gjitha veprimet, politikat dhe procedurat dokumentohen përmes:

- Raporteve periodike (muajore, gjashtë mujore dhe vjetore)
- Strategjive Zhvillimore Lokale
- Strategjive Zhvillimore Rajonale
- Strategjitë Zhvillimore Lokale dhe Strategjitë Zhvillimore Rajonale nuk janë të azhuruara në mungesë të fondeve, presim që përmes bashkëpunimit me komunitetin ndërkombëtarë dhe trupave të krijuara nga fondet e BE së si (AZHR Lindje) të modifikojmë në përputhje me nevojat për vitet në vijim .

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik është formuar në vitin 2012 dhe në strukturën e vetë organizative gjatë vitit 2015/2016 ka këtë strukturë të funksionimit ku janë të përfshira proceset kyçe të punës e cila përmban :

- a. Zyra për Promovimin e Investimeve ;
- b. Zyra për Energji dhe Efiçencë
- c. Qendrën e Inkubatorit të Bizneseve
- d. Qendrën për Regjistrimin e Bizneseve.
- e. Inspektorët e tregut
- f. Zyrtaret e Taksës Komunale
- g. Zyra për Financa

Në kuadër të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik gjatë vitit 2015/2016 kemi edhe dy programe Komisionit Evropian (IPA fonde) të cilat bashkë financohen (participon) edhe Komuna e Gjilanit dhe implementohen nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik .

Këto programe janë në fazën intensive të realizmit të projekteve – fjala është për programet :

- Programi BE – BNK Bashkëpunimi Ndërkufitarë Komuna e Gjilanit (KS) & Komuna e Çairit (MK) e cila implementohet edhe në bashkëpunim me dy organizata jo qeveritare Organizata AgorEko (Gjilan) dhe Initiative for European Perspective (Çair), emri i projektit: Valorizimi i tregtisë tradicionale dhe potenciali sociekonomik)
- Programi BE – EURED, emri i programit: Zhvillimi i Agrobizneseve në Regionin e Gjilanit, që po realizohet nga Organizata CARE dhe ATRC.
- Kontrollat e brendshme kyçe:
- I gjithë stafi i drejtorisë (zyrtarëve) për angazhimet e veta raporton me shkrim te Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- Konsultimet dhe takimet e përditshme me stafin e drejtorisë për veprimet dhe koordinimet me sektorët tjerë dhe drejtorit
- Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik merë pjesë rregullisht në takimet e rregullta dhe sipas nevojës në Bordin e Drejtoreve
- Po ashtu Drejtoria për Zhvillim Ekonomik koordinon punët edhe me Komitetin për Zhvillim Ekonomik.

Konsiderojmë përshkrimin e lartshënuar si një kontroll për punën efikase, pa e anashkaluar vijimin e rregullt në punë i cili monitorohet në mënyrën elektronike

Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik sistemet kyçe të TI-së i ka të përbashkëta dhe unike me të gjitha drejtorit tjera komunale.

Vlerat kyçe për matjen e performances të stafit:

- Aftësitë e mira të stafit në planifikim, monitorim dhe raportim,
- Aftësitë e mira të stafit në përgatitjen e raporteve dhe komunikuese dhe të punës ekipore,
- Aftësi në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare dhe lokale,
- Të besueshëm, të saktë dhe të përkushtuar pas punës,
- Aftësi dhe njohëse e mirë e problemeve të qytetarëve dhe në menaxhimin e problemeve – sfidave

Drejtorja për Zhvillim Ekonomik të gjitha komunikimet me organizatat të brendshme dhe të jashtme kryhen përmes:

- Komunikimit zyrtar elektronike

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka krijuar ura të bashkëpunimit të mirë, të sigurtë dhe të gjithanshëm me të gjithë mekanizmat relevantë lokal dhe ndërkombëtar të cilat me programet e tyre ndihmojnë zhvillimin ekonomik lokal.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik po koordinon aktivitet në realizimin e projekteve me komunitetin ndërkombëtar (donatore të ndryshëm si USAID, GIZ, KfE, BE, ChEB, BERZH, ADA, American Chamber of Commerce in Kosovo, TIKA, OSCE, HELP, ...)

Po ashtu po koordinon aktivitetet e saja edhe në nivelin lokal dhe qendror (ministrat e linjës si Ministrin e Financave programi Soft Loan Project, Departamentin e Partneriteti Publiko Privat, Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë – Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA) Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Ministrin e Bujqësisë etj.

Për momentin nuk kemi identifikuar ndonjë shqetësim për sa i përket përdorimit efikas, efektiv, apo ekonomik të burimeve.

Në rast se do të hasim në ndonjë shqetësim, ne do ta njoftojmë ekipin Auditimit të Brendshëm përmes një shkrese zyrtare.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Duke u nisur nga obligimet që dalin nga ligjet në fuqi: Ligji për mbrojtje nga zjarri, Ligji mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, detyrat e parashtruara nga AME, Statuti i komunës dhe detyrat e dala nga plani i vlerësimit të rrezikut në Komunën e Gjilanit.

Përvojat e përfituara nga viti që lamë pas si dhe situatat e papritura me të cilat mund të përballemi në vitin 2016 për shkak të ndryshimeve klimatike që kanë goditur komunën tonë.

Drejtoria Për Mbrojtje dhe Shpëtim në vitin 2016 planifikon këto aktivitete:

1. Do të përfundohet plani i veprimit të reagimit për situata emergjente, i cili plan është në përfundim e sipër dhe së shpejt pritet të diskutohet në kuvend ku pritet të miratohet, aprovohet si dokument zyrtar.
2. DMSH do të ngrit në nivel të lartë mbikëqyrjen emergjente dhe gatishmërinë e institucioneve për veprime efikase në rast të situatave emergjente.
3. në vitin 2015 DMSH për shkak të ndryshimeve klimatike është përballë me vërshime të shumta prandaj për këtë shkak edhe në vitin 2016 DMSH do të bëjë përpjekje për rritjen e kapaciteteve të saja teknike, pajisjeve të cilat i posedon dhe në bashkëpunim me drejtorinë për Shërbime Publike si dhe me qytetarë do të punoj në zvogëlimin e dëmeve të cilat paraqiten në raste të vërshimeve eventuale.
4. Duke aftësuar pajisjet të cilat i posedon dhe rritjen e kapaciteteve me dy pompa të mëdha thithëse të ujit, nga të cilat pompa njëra është riparuar kurse tjetra pompë është donacion nga një bashkatdhetari ynë që punon dhe jeton në Zvicër.
5. Do të përpilojmë planin për situata emergjente, (në qoftë se paraqitet nevoja për plane të veçanta) për situata të tjera që mund të ndodhin në vitin 2016, me qëllim të eliminimit apo zvogëlimin të pasojave eventuale.
6. Do të mbikëqyrë gatishmërinë emergjente të organeve, institucioneve si dhe ndërmarrjet private, në mënyrë që të vlerësoj gatishmërinë e tyre për përballjen me Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.
7. Në sferën e emergjencave do të bashkëpunojmë ngushtë me organet, institucionet si: FSK-ne, PK-në, KFOR- Amerikan, QKMF, Kryqin e Kuq(KK), Drejtorin për Shërbime Publike, Drejtorinë për Urbanizëm, Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenien Sociale, si dhe organizatat joqeveritare, në mënyrë që së bashku të japim kontributin në dhënien e ndihmës qytetarit për dëmet që eventualisht mund t'i ketë nga fatkeqësitë natyrore.
8. Do të organizohen kurse, ligjërata dhe seminare në bashkëpunim me subjektet tjera të përmendura më lart në mënyrë që të rrisë aftësinë e punëtorëve për intervenime emergjente në rast nevojë.
9. Do të bëjmë vlerësimin e situatës së rrezikshmërisë në qoftë se ato ndodhin në Komunë duke reaguar me anë të Planit të Reagimit Kombëtarë dhe sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave njëkohësisht duke ndërmarr masa preventive në

parandalimin dhe evitimin e pasojave të rrezikshme, në rastet e jashtëzakonshme ose në rastet të kanosjes së rrezikut të madh, i propozon kryetarit të komunës nevojat e shpalljes së gjendjes emergjente në territorin e Komunës ose pjesëve të Komunës të prekura nga fatkeqësitë natyrore apo sëmundjeve ngjithëse (konform Planit të Reagimit Kombëtar).

10. DKMSH - në periudhën e ngritjes së temperaturave të larta, kur rreziqet nga përhapja e zjarreve janë më të mëdha do të ngrit nivelin e mobilizimit të punëtorëve sidomos të SHZSH-së dhe Shërbimit Vullnetar Zjarrfikës. Do të kushtohet kujdes i veçantë komunikimit me qytetarët në ato pjesë ku munden me u paraqite zjarre dhe me një komunikim të shpejtë të ndikojmë që dhe vitin 2016, dhe qytetarët të jenë bashkuar me ne që të ruhet pasuria jonë e përbashkët si ajo Publike ashtu dhe ajo Private
11. Do të obligoj shërbimet përkatëse që gjatë tërë kohës të bëjë mirëmbajtjen e pajisjeve si dhe aftësimin e automjeteve për intervenime efikase dhe me kohë.
12. Do të bashkëpunojmë edhe me mjetet e informimit me qëllim të sensibilizimit të opinionit publik mbi rrezikun që paraqesin Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësi tjera si dhe nevojën e menaxhimit të këtyre fatkeqësive edhe nga vetë qytetari.
13. Sektori i preventivës i DKMSH-së, do të bëjë kontrolle permanente dhe të rregullta të ndërmarrjeve publike, institucioneve, ndërmarrjeve private dhe organeve tjera mbi nevojën e respektimit të masave obliguese të parapara me ligjet për mbrojtje nga zjarri dhe Ligjin mbi Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqit tjera. Do të shtohet dukshëm numri i kontrolleve.
14. DKMSH - në vitin 2016, do të mbikëqyrë terrenet të cilat janë të rrezikuara nga shembjet e dheut në mënyrë që me intervenimet paraprake e në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe të tjerat të pengoj dëmet eventuale që shkaktohen nga këto raste dhe duke monitoruar e përcjell nivelin e ujërave në komunën tonë që dëmet të jenë sa më të vogla në rast të vërshimeve të mundshme.
15. DKMSH-ja do të përcjell situatën e Sigurisë në Komunë në mënyrë që me kohë të informoj kryetarin e Komunës me qëllim të evitimit të situatave të padëshirueshme dhe konfliktuale, e sidomos nga marrëdhëniet ndërnacionale.
16. kujdes i veçanta do t'i kushtohet aftësimin të punëtorëve nëpërmes kurseve të ndryshme që organizon AME-ja.
17. Në këtë vit DKMSH do të implementoj pjesërisht projektin për vendosjen e shenjave informuese ku është e ndaluar inicimi i zjarreve nëpër fshatra dhe pjesë me interes nacional. (në pyje, në vendet siç janë pishat pranë pendës së fshatit Livoq dhe pjesë të tjera)
18. Planifikojmë trajnime nga lëmin e Mbrojtjes nga zjarri dhe përdorimi i aparateve kundër zjarrit në të gjitha shkollat në territorin e Komunës së Gjilanit, me stafin teknik që ata të jenë të gatshëm që ti përdorin dhe të jenë intervenuesi i parë deri sa ekipet tona të jenë në vend-ngjarje.
19. Planifikojmë dhe një ushtrim me gjithë faktorët relevantë për siguri, ku do të inskenohet një situatë emergjente në Komunë dhe të demonstrohet gatishmëria dhe veprimi i përbashkët në situata Emergjente.

20. Përveç detyrave të parapara në këtë plan DKMSH-ja, do të angazhohet në të gjitha detyrat tjera të cilat mund të paraqiten por të cilat nuk kanë mundur të parashihen për shkak të natyrës së punës dhe dukurive të paparashikueshme

PLANI I PUNËS I ZYRËS SË PREVENTIVËS PËR VITIN 2016

Bazuar në detyrimet ligjore të kësaj zyre, sidomos atyre që burojnë nga ligjet në fuqi si: Ligji për mbrojtje nga zjarri, Ligji mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Ligji për Procedurën Administrative dhe ligjeve tjera në fuqi, mandej detyrat e parashtruara nga AME, Statuti i komunës së Gjilanit dhe detyrat e dala nga Plani i Vlerësimit të Rrezikut dhe Plani Operativ Emergjent të Komunës së Gjilanit.

Detyrat e sektorit të preventivës do të realizohen sipas asaj që do të prezantojmë në vijim:

- Objektet e kategorisë së parë do të kontrollohen së paku një herë në vit sipas nevojës edhe më shpesh.
- Objektet e kategorisë së dytë është obligim të kontrollohen një herë në dy vite.
- Objektet e kategorisë së tretë një herë në tri vite, e sipas situatave edhe më shpesh.
- Edhe në vitin 2015 prioritet i shërbimit të preventivës në kontrollimin e masave për mbrojtje nga zjarri do të kushtohet shkollave, spitaleve, PTK, ambulantëve shëndetësorë, enteve parashkollore, stacioneve për furnizimin e automjeteve me derivate, KEK-ut, palestrave sportive, marketeve dhe të gjitha objektet ku tubohen numër i madh njerëzish.
- Në territorin e komunës veprimtarinë e tyre e zhvillojnë një numër i madh i stacioneve (pompave) të benzinës në kuadër të cilave kanë të vendosura edhe depozita gazi, kjo ka të bëjë me rritjen e rrezikut nga zjarret dhe rrezikimit të jetës së njerëzve dhe pronës, prandaj sektori i preventivës prioritet më të madh të kontrollit do të kushtoj këtyre objekteve, me qëllim të zvogëlimin të rrezikut nga shpërthimi i zjarreve në këto objekte si dhe funksionimit të aparaturave për shuarjen e zjarrit.
- I tërë aktiviteti i sektorit të preventivës ka për qëllim ruajtjen e jetës së njerëzve, pasurisë shoqërore dhe asaj private, shtazëve dhe mbrojtjen e ambientit.
- Përveç detyrave të parapara me këtë plan të punës zyra e preventivës do të zhvillojë dhe aktivitete tjera të cilat nuk kanë mundur të përfshihen me këtë plan pune.
- Detyrat tjera që dalin nga kuvendi dhe kryetari i komunës me qëllim të parandalimit, eliminimit të pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

PLANI I PUNËS PËR NJËSINË PROFESIONALE TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT PËR VITIN 2016

Objektiv kryesor i Njesisë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit do të jetë ngritja e nivelit të gatishmërisë në kryerjen e të gjitha obligimeve profesionale me të gjitha kapacitetet egzistuese: si planifikimi e zbatimi i masave preventive të mbrojtjes nga zjarri, shuarja e zjarreve dhe shpëtimit, mbrojtja e pasurisë dhe reagimi në çdo situatë emergjente që mund të paraqitet.

Për vitin 2016, përkushtimi ynë do të përqëndrohet në ngritjen profesionale të personelit, në mirëmbajtjen dhe freskimin e mjeteve teknike, si dhe krijimin e kushteve sa më të mira për NjPZSh.

Lidhur me avancimin profesional të zjarrfikësve, përveq organizimit të trajnimeve në QTI, në Vushtrri, nuk do të mungojë as angazhimi ynë për freskimin e diçkës, përmes trajnimeve mobile, si ato teorike, ashtu edhe praktike në NjPZSh.

Në Qendrën e Trajnimeve dhe Integritit në Vushtrri, në bazë të plan-programit, do të dërgohet lista e zjarrfikësve të cilët do t'i ndjekin trajnimet gjat vitit 2016.

Ndërsa mësimet teorike dhe trajnimet në NjPZSh, do të mbahen sipas një plani si vijon:

Janar - Taktika e Zjarrfikësve :

- Djegja dhe Proqesi i djegies, (Teori)
- Kushtet elementare për djegie (Teori)
- Mjetet për Shuarje (Teori)
- Zjarret dhe Llojet e zjarreve, (Teori)
- Identifikimi i Materjeve të Rrezikshme, (Teori)

Shkurt - Teknika e Zjarrfikësve:

- Pajisjet Personale,
- Pajisjet për Shuarje me ujë
- Pajisjet për shuarje me shkumë kimike dhe ajrore
- Pajisjet për ngjitje në lartësi (Shkallët dhe llojet e tyre)
- Pajisjet për Aksidente të Komunikacionit Rrugor (AKRR),

Mars -Teknika e Zjarrfikësve:

- Pajisjet për Shpëtim
- Pajisjet Mbrojtëse (Rrobot ,Aparatat e frymmarrjes BD-96)
- Pajisjet teknike
- Pajisjet për Zhytje në ujë,
- Pajisjet për ndriçim

- Pajisjet sanitare etj.
- Vendosja e paisjeve të zjarrfikjes
- Shpëtimi dhe evakuimi etj.

Prill – Ushtrime Praktike

- Përsëritja e përdorimit të Teknikës së Zjarrfikësve në Praktikë
- Shpejtësia e daljes së ekipit për intervenim,
- Ushtrime -Aksion i kombinuar,
- Ushtrime -Aksion në katet e ndërtesave me anë të shkallëve,
- Ushtrime- Me Paisjet AKRR,
- Ushtrime –Përdorimi i Shkumës Ajrore

Maj - Vazhdim i ushtrimeve, dhe punëve të cekura më lartë.

Qershor - Vazhdim i ushtrimeve, dhe punës,

- Pregaditje për ndonjë ushtrim publik,
- Apo pjesmarrje në ndonjë manifestim tjetër.

Korrik , Gusht dhe Shtator – Për shkak të intervenimeve të shumta që mund t'i kemi gjat sezonës verore, nuk parashohim ndonjë angazhim tjetër pos mobilizimit më të madh.

Tetor - Vazhdohet me ushtrime, përdorimi i AF, paisje për AKRR dhe përsëritja e temave të zhvilluara nga Taktika e zjarrfikës .

Nëntor - Përsëritja dhe Vazhdimi me Teknikën e Taktikën e Zjarrfikjes,

- Pregaditja e automjeteve për sezonën e dimrit.

Dhjetor - Vlersimi i puntorëve mbi punën dhe aftësimin profesional,

- Pregaditja e raporteve për vitin Kalendarik.
- Pregaditja e planit të punës për vitin vijues,
- Planifikimi, deklarimi mbi shfrytëzimin e pushimeve vjetore për vitin vijues.
- Planifikimi i orarit për trajnime të personelit në QTI në Vushtri për tremujorin e parë, dytë, tretë dhe katërt, në mënyrë që personeli të jetë gjithmonë në freskim me njohuri të reja profesionale .
- Angazhimi dhe përkushtimi ynë gjithashtu do të jetë i përqëndruar rreth mirëmbajtjes së automjeteve, paisjeve dhe teknikës, për të qenë gjithmonë të gatshëm , për t'ju përgjigjur thirrjeve dhe nevojave të qytetarëve. Poashtu do të bëjmë mbushjen e bombolave të Aparatave të frymmarrjes, jo vetëm për Shërbimin tonë por, edhe për Shërbimet tjera të regjionit : NjPZSh- Dardanë, NjPZSh- Viti, NjPZSh-Novobërdë.

Gjatë vitit 2016 planifikojmë disa punë shtesë siç janë:

- Kontrollimi detal, përgatitja e automjeteve për regjistrim (Shkurt)
- Riparimi i defekteve të automjeteve që mund të paraqiten
- Lyerja e nyjeve të automjeteve (punë e regullt)
- Ndërrimi i vajit në automjete.
- Rregullimi i oborrit prapa objektit
- Rregullimi i një gjysmë fushe për aktivitete sportive (objektiv i vazhdueshëm)
- Rregullimi i semeringave në pompat statike në BMC- 5,6, për shkak të rrjedhjes së ujit.
- Kontrollimi detal për përgatitjen e automjeteve FAP-3,4, për regjistrim (Maj)
- Ngjyrosja apo renovimi i objektit brenda .
- Përkushtim rreth fillimit dhe realizimit të projekteve (vazhdimi i Garazhave, dhe Nxemja qëndrore).

Për realizimin e punëve të cekura më lart, nevojitet edhe mbështetje financiare, nga Komuna apo nga AME-MPB, gjë që shpresojmë.

Përfundim: Përveç detyrave të parapara me këtë plan punë DMSH do të zhvilloj dhe aktivitete tjera të cilat nuk mund të përfshihen me një plan pune, aktiviteti i DMSH –ës në rritjen e përpjekjeve për ripërtirjen e punëtorëve të SHZSH-ës si nga mosha dhe aftësia profesionale jo vetëm të shërbimit profesional të zjarrfikës por edhe aftësimin e njësive vullnetare të zjarrfikës.

Sigurimin e pajisjeve për intervenim .

Detyrat tjera që dalin nga kuvendi dhe kryetari i komunës me qëllim të parandalimit, eliminimit të pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Punët dhe detyrat punuese të stafit të Shërbimit të Gjendjes Civile pranë Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme KK Gjilan për vitin 2016 janë të planifikuara dhe programuara në mënyrë taksative sipas Planit dhe programit të punës të Shërbimit për vitin në vijim.

Punët dhe i tërë aktiviteti i Shërbimit të Gjendjes Civile (në tekstin e mëtutjeshëm “SHGJC” është i bazuar në Ligj dhe akte të tjera nënligjore të Kuvendit të Kosovës, vendimeve të KK në Gjilan dhe organeve - Ministrive të tjera sipas hierarkisë në nivel të vendit.

Bazë e punës së SHGJC është Statuti i komunës së Gjilanit, Ligji mbi Administratën e Përgjithshme, Ligji mbi Gjendjen Civile, Ligji i Kosovës mbi Familjen, Ligji mbi emrin personal, Shtetësisë e ligje dhe udhëzime Administrative të tjera të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe MPB në Prishtinë.

SHGJC në punën e vet gjatë vitit në vijim është i obliguar që të bazohet në afate kohore në kryerjen e punëve dhe vendosjen e kërkesave drejtuar asaj, sepse kemi të bëjmë me punë dhe afate permanente dhe ato të përcaktuara në mënyrë taksative me Ligjin mbi Procedurën Administrative.

Në vijim të këtij plan programi paraqiten disa nga punët dhe detyrat punuese dhe afatet në kuadër të të cilave duhet kryer punët-kërkesat e caktuara.

1. Vendosja në shkallë të parë sipas kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve, personave fizik dhe juridikë.

Afati kohorë: Në afat ligjor, varësisht nga natyra e kërkesës.

2. Regjistrimi i Lindjeve dhe Vdekjeve të ndodhura në entin shëndetësor, spital apo Klinikën përkatëse sipas Fletëparaqitjeve - njoftimeve me shkrim.

Afati kohorë: Brenda ditës ose në afat Ligjor brenda 30 ditësh nga data e lindjes-vdekjes.

3. Regjistrimi i lindjeve dhe vdekjeve të ndodhura në shtëpi e të pa regjistruara brenda afatit ligjor sipas kërkesave –njoftimeve të palëve të interesuara me procedura administrative-me vendim të organit kompetent.

Afati kohorë: Afati ligjor.

4. Regjistrimi i lindjeve, kurorëzimeve dhe vdekjeve të ndodhura jashtë Republikës së Kosovës të cilët vendbanimin e kanë në Gjilan, sipas kërkesës së palëve, MPB ARC Prishtinë dhe dokumentacionit të nevojshëm.

Afati kohorë: Sipas kërkesës së MPB-ARC brenda ditës rastet tjera në afat ligjor.

5. Kërkesat për kurorëzime të bashkëshortëve.

Afati kohorë: Sipas dokumentacionit të kompletuar brenda 48 orëve.

6. Kërkesat për marrjen e certifikatave të lindjes, ekstrakte të lindjes, certifikata të martesës, Vdekjes, Vendbanimi, Familjare, statusit Martesor, shtetësisë vërtetim nga arkivi, vendqëndrimi, identiteti, e të tjera.

Afati kohor: Brenda ditës, si dhe on-line në kohë reale përmes ueb faqes: kk.rks-gov.net/gjilan dhe E-Kioska.

7. Lëshuara e dokumenteve në bazë të shënimeve me të cilat disponon DAP dhe ato sipas dispozitave të Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Afati kohorë: në afat ligjor me dokumentacion të kompletuar brenda ditës.

8. Në procedura administrative nxjerrja e aktvendimeve për regjistrime të mëvonshme në Librin e amzës së të lindurve, kurorëzuarve dhe vdekurve në Gjilan dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Afati kohor: 30 ditë afat ligjor, sipas mundësisë edhe para këtij afati.

9. Pranimi i kërkesave për gjetjen e kopjeve të dokumenteve personale, Letër njoftim pasaporta apo Patentë shofer të qytetarëve të marra në ish SPB-në në Gjilan para 10.06.1999. Vendimet e DAP KK Gjilan për nevojat të shërbimit dhe palëve të interesuara.

Afati kohorë: Ditën e nesërme e për rastet urgjente menjëherë.

10. Mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik-administrimi i internetit dhe intranetit, trajnim për përdorimi dhe punës me kompjuter të gjithë stafit dhe mirëmbajtja e serverëve dhe bekapit (grumbullimi i të dhënave). Këtë vit duhet të jemi më të kujdes-shëm ndaj zyrtarëve në ZGJC në fshatra të cilët gjat vitit 2013 kanë hasë në vështirësi dhe probleme sidomos me programin e ri të gjendjes civile.

Detyrë permanente.

11. Evidenca, protokolimi, skanimi, përcjellja dhe mirëmbajtja e lëndëve të cilat janë të SHGJC-DAP dhe aktet e tjera të cilat i nxjerr e njëjta.

Detyrë permanente.

12. Rekomandimet, udhëzimet dhe vendimet e ndryshme të cilat dalin nga MPB ARC Prishtinë Kuvendi komunal i Gjilanit, Bordi i drejtorëve, komisioneve dhe komiteteve.

Detyrë permanente.

13. Përcjellja e punës së punëtorëve ditore,javore,mujore,tre mujore,gjashtëmujore,nëntë mujore dhe njëvjeçare dhe hartimi i raporteve me shkrim ose on-line.

Detyrë permanente.

14. Raportimi i punës mujore sipas kërkesës edhe javore të Shefit,Drejtorit te DAP në Dikasterin përkatës në MPB ne Prishtinë.

Detyrë permanente.

15. Evidentimi,klasifikimi dhe asgjësimi i materialeve të shumta në arkivin pasivë të SHGJC në bashkëpunim me Arkivin komunal në Gjilan.

Detyrë e përhershme,nevojë imediate

16. Ky plan mund të pëson ndryshime pozitive në ato segmente të cilat paraqiten si rezultat i kohës dhe momentit e që duhet të jetë pjesë përbërësee SHGJC dhe punë permanente e sajë.

17. Hartimi i planit të punës dhe propozimi i buxhetit të SHGJC,realizimi iobligimeve buxhetore gjer në fund të vitit 2014.

Do ta bën DBI KK Gjilan

18. Mbikëqyrjen e realizimit të këtij plan programi përfshirë edhe realizimin eobligimeve buxhetore,efikasitetit në punë,kualitetin dhe kuantitetin e tërë veprimtarisë së SHGJC për vitin 2016 e bën Drejtori i Drejtorisë përAdministratë të Përgjithshme KK Gjilan me ndihmën e stafit udhëheqës.

Detyrë permanente e drejtorit, shefave tësektorëve dhe çdo punëtori veç e veç.

19. Të gjendet mundësia që në zyret e Gjendjes Civile në fshatin K.Polë dhe Verbicë të Zhegocit,aty ku gravitojnë 10 dhjetë fshatra nga na e PTK-ës të instalohet një antenë përmes së cilës ne do ta instalonim programin e punës,sepsenë mungesë të valëve zyrtaret kryejn punët atje ndersa duhet per qdo ditë të vijn ne SHGJC DAP KK Gjilan qe ti shtypin ato dokumente te gjendjes civile.

Ka tri vite qe kerkojm kete instalim te rrjetiot nga kompetentet e PTKsë ne Gjilan dhe Prishtinë por akom anuk kemi mund ta rregullojm,nese e marrim parasysh se kemi te bejm me një rajon-Zonë Operative te Karadakut –Gjilanit te lejohet ky terr eshte e patolerueshme madje edhe e pa lejueshme.

Qyteti i Gjilanit është shtuar aq shum sa që nuk kemi shenime se kush vjen,ku qëndron-vendoset dhe ku-kur dhe ku shkon nga Gjilani.Nji gjendje të këtill siq e kemi në qytet fatmirësisht nuk e kemi edhe në 63 fshatra të komunës së Gjilanit të cilat mbulohen me 11 zyret ekzistuese në fshatra.

Mbi këtë bazë kërkojm që qyteti Gjilanit të ndahet në 7 shtatë zona-regjione dhe atë në fillim të këtij viti, menjëher ti hapim së paku 4 zyre në të katër anët e qytetit në të cilat qytetarët tanë do ti kryenin punët e veta me qka do të shkarkohet shërbimi në qendër. Me këtë do të ndihmohet me të madhe arsimi i cili qdo fillim viti shkollor po has në probleme dhe vështirësi të mëdha rreth shpërndarjes së nxënësve nëpër shkolla aty ku vërtet familja e ka vendbanimin e përhershëm.

Me hapjen e këtyre zyreve të gjithë ata qytetar apo familje të tëra fillimisht do të tregojnë se nga kanë ardh dhe ku janë vendos kanë blerë shtëpi, banesë apo jetojnë më qera kuptohet me kontratë të vërtetuar, mbi këtë bazë edhe do ti lëshohet një document vendbanimi apo vendqendrimi i përkohshëm. Kjo do të na ndihmonte edhe për evidentimin e të huajve të cilët janë të shumtë dhe nuk kanë asnjë të vetmin document.

Duhet kuptuar natyrën e punës së SHGJC (në të kaluarën e as tani nuk i është kushtue kujdesë, ka qenë e udhëhequr nga njerz , profesionalisht jo të ngritur thjesht kush ka mbetë në rrugë është dërgue në ish Ofiqari, prandaj edhe tani nuk po kuptohet rëndësia e tij gjë që me argumentin arsyeshëm duhet të bëhet.

Atë që nuk ka dashtë ta kupton dhe ta vlerëson drejtë me decenjë të tëra, tanikëtë e ka kuptue faktori ndërkombëtar-euleksi i cili jo rastësisht si kusht për liberalizimin e vizave dhe ofrimit në UE ka parashtrur si kusht konsolidimin e këtij dokumentacion, Shërbimeve dhe zyrtarëve të cilët punojnë në këto shërbime, prandaj me të drejtë e ka quajtur Alfa dhe omega, ABC eda e qdo SHCK përkatësisht Administrate shtetërore.

Ky plan i punës siç u cek më lart mund të pëson ndryshime gjithëher duke patur parasysh kërkesat e qytetarëve, Drejtorisë dhe Dikasterit perkates pramnjë MPB ARC ne Prishtinë e cila e monitoron dhe kontrollon profesionalitetin e punës së [Shërbeve të GJC ne tërë Republikën e Kosovës..

Perkunder të gjitha atyre që u ceken gjer tani është momenti i fundit që të shtohet efikasiteti, përgjegjësia dhe disiplinën në punë, qasja më e mirë dhe adekuate e zyrtarëve ndaj qytetarit-palëve të cilat kërkojnë shërbime të ne, unifikimi i ofrimit të shërbimeve, profesionalizimi dhe aftësimi për punë në sistemin e ri dhe të mirë të gjendjes civile puna online përmes faqes www.kk.rks-gov.net/gjilan. Zyrtarët e SHGJC duhet vazhdimisht të perfeksionohen, shkollohen trajnohen me qëllim që të jenë sa më afër me qytetarin dhe programet e reja të Gjendjes civile dhe ligje e Udhëzime administrative të organeve kompetente të cilat kanë të bëjnë me gjendjen Civile dhe të tjera.

QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE (QSHQ)

Zbatimi i ligjeve, rregulloreve dhe vendimeve të aprovuara nga organet qendrore e lokale të cilat mundësojnë dhe lehtësojnë procedurat në kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Përkujdesja edhe zbatimi i të gjitha akteve të nxjerra nga KK- e që reflektojnë me punën e QSHQ-ës.

Përkujdesja për mbarrëvajtjen e punës, së QSHQ-ës, gjatë gjithë orarit të punës si dhe në zbatimin e kërkesave të palëve që i adresohen organeve të komunës.

Përkujdesja e protokollit intern dhe përkujdesja lidhur me afatshëmërisë së kthimit të përgjigjeve për lëndët në procedurë edhe për lëndët që është zhvilluar procedurë.

